

KONTRATË BINJAKËZIMI
Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Përmirësimi i Diseminimit – Zhvillimi i Strategjisë së Diseminimit

Komponenti nr 4.9.1

Misioni i udhëhequr nga
Jesper Ellemose Jensen
&
Annegrete Wulff,
Statistikat e Danimarkës

4-7 Maj 2015

IPA 2012

Emri i autorit, adresa, e-mail

*Annegrete Wulff
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173155
Email: awu@dst.dk*

*Jesper Ellemose Jensen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173244:
Email: jej@dst.dk*

Përmbledhje

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Komentet e përgjithshme	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Vlerësimi dhe rezultatet	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
2.1 Dokumentet aktuale mbi diseminimin	4
2.2. Materiali relevant i BE/Eurostat në lidhje me Diseminimin	5
2.3 Strategjitë, politika dhe Procedurat	6
2.4 “Kalimi” nëpër Kodin e Praktikës	7
2.5 Versioni i parë i politikës së Diseminimit	8
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	9
Aneksi 1. Termat e Referencës	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Aneksi 2. Personat e takuar	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Aneksi 3 – Matrica e pritshmërive nga Kodi i Praktikës	15
Aneksi 4 – Pikët kryesore për politikën e diseminimit.....	28

Lista e Shkurtesave

CoP	Kodi i Praktikës
GIS	Sistemi Informatave Gjeografike
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
TeR	Termat e Referencës
QAF	Korniza e Sigurimit të Cilësisë

1. Komentet e përgjithshme

Ky është aktiviteti i parë në komponentin 4.9.1. Aktivitetet në komponentin 4.9.1 janë shtuar në projektin e binjakëzimit pas fillimit të tij dhe me kërkesën specifike nga ASK-ja. Qëllimet kryesore të 4.9 janë

- Vlerësimi i diseminimit aktual në ASK
- Harta rrugore për zhvillimin e strategjisë së diseminimit

Programi i ASK-së i statistikave zyrtare 2013-2017 thekson që duhet të zhvillohet një politikë diseminimi, përfshirë udhëzuesit për dizajnin e tabelave, grafikëve dhe për përmirësimin e webfaqes. Tashmë është punuar në kuadër të Projektit të Binjakëzimit në zhvillimin e udhëzuesve për tabelat dhe grafikët (*Shih: raportet mbi Aktivitetet 4.4.1 dhe 4.4.2 – Krijimi i udhëzuesve për dizajnin e publikimeve të printuara dhe elektronikë, nga Huttunen dhe Stefansson*). Në Qershor 2015 do të ketë një aktivitet në kuadër të projektit të binjakëzimit edhe lidhur me të punuarit me shtypin dhe mediat.

Projekti i Binjakëzimit ka për qëllim të:

- Zhvillojë një Strategji formale për diseminimin në ASK
 - Në përputhje me kërkesat Evropiane/praktikat më të mira
 - Në përputhje me legjislacionin në Kosovë
 - Reflektojë nevojat e grupeve të përdoruesve
- Zhvillojë / azhurnojë politikat e nevojshme
 - Procedurat e shkruara / udhëzuesit për procesin e diseminimit

Projekti i Binjakëzimit do të vazhdojë deri në fund të Shkurtit 2016, që do të thotë se Strategjia e Diseminimit duhet të jetë e gatshme për aprovim nga menaxhmenti i lartë i ASK-së më së voni deri në fund të Janarit 2016.

Konsulentët dëshirojnë të falenderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

2.1 Dokumentet aktuale mbi diseminimin

Politika e Diseminimit e ESK-së

Politika e diseminimit e ASK (atëherë: Enti i Statistikave të Kosovës – ESK) është shkruar dhe aprovuar në vitin 2003. Politika daton që nga Kodi i Praktikës i Eurostat-it, por bazohet në 10 parimet e dokumentit Parimet Fundamentale të Kombeve të Bashkuara në fushën e Statistikave. Sot, politika e diseminimit e vitit 2003 duket e vjetruar në disa mënyra. I përziën qëllimet e politikës me procedurat e brendshme dhe politikat me qëllimet strategjike.

Gjithashtu, përmban përshkrimin e niveleve të stafit. Pasi dokumenti është 12 vjet i vjetër, ai është i periudhës para kalimit nga diseminimi në letër në diseminimin përmes internetit, që ka ndodhur në ASK dhe në të gjitha Institutet e tjera Statistike Kombëtare.

Programi i Statistikave Zyrtare 2013-2017

Programi i Statistikave Zyrtare 2013-2017 përshkruan vizionin dhe misionin e ASK-së dhe adreson diseminimin në kuptimin më të gjerë. Dokumentet i kushtojnë vëmendje: grupeve të përdoruesve dhe rëndësisë së dialogut me përdoruesit, kur përcaktohen statistikat/anketat e reja, që duhet të implementohen. Në këtë program, studentët nuk konsiderohen si grup i veçantë.

Në pjesën mbi përdoruesit, në program thuhet: Kosova ka për qëllim të jetë në përputhje me rregulloret e BE-së. Prandaj rregulloret e BE-së për statistika do të jenë standardi që do të arrihet. Në këtë aspekt ASK demonstroi përkushtimin për të përcjellë rekomandimet dhe udhëzuesit e BE/Eurostat-it.

Ligji i Statistikave Zyrtare (Ligji 04/L-036)

Paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit i përcaktojnë parimet dhe standardet e cilësisë në të cilat bazohet sistemi statistikor i Kosovës.

Udhëzuesi për e-qeverisje në Kosovë

Me sa kemi kuptuar, ekziston një legjislaturë/udhëzues që mbulon e-qeverisjen dhe po ashtu webfaqet/ shërbimet përmes web-it të ASK-së. Pasi nuk kemi njohuri për legjislacionin në rajon, presim që ASK të njohë dhe adaptojë të gjitha informatat relevante në politikat e tyre.

2.2. Materialet relevante të BE/Eurostat-it në lidhje me Diseminimin

Derisa shumica e statistikave të kërkuara nga BE/Eurostat-i, sipas *acquis*, janë të mbuluara nga legjislacioni në mënyrë të drejtpërdrejtë, aspekti i diseminimit nuk është mirë i definuar. Megjithatë, një numër i kërkesave të përgjithshme rrjedhin direkt nga Kodi i Praktikës të Eurostat-it. Në procesin e rishikimit profesional, Institutet Statistike Kombëtare duhet të rishikojnë pajtueshmërinë me secilin nga 15 parimet e Kodit të Praktikës dhe indikatorët përkatës. Menaxhmenti i ASK-së ka kërkuar të realizohet në ASK një aktivitet i tillë, i ashtuquajtur rishikim i adaptuar profesional, në vitin 2016 ose 2017.

Kodi i Praktikës

Gjatë misionit, kemi diskutuar me pjesëmarrësit lidhur me secilin parim në Kodin e Praktikës dhe indikatorët përkatës me qëllim analizimin e përputhshmërisë me BE-në. Për t'i lehtësuar diskutimet rreth Kodit të Praktikës dhe Kornizës së Sigurimit të Cilësisë, është siguruar përkthimi jozyrtar i dy dokumenteve në gjuhën shqipe.

Shumë aspekte, që aktualisht ASK-ja realizon në fushën e diseminimit, janë në përputhje me pritshmëritë e Kodit të Praktikës.

PSI - Direktiva

Përveç Kodit të Praktikës, direktiva mbi ri-përdorimin e informimit të sektorit publik (Direktiva 2003/98/EC¹), e njohur si 'Direktiva PSI ' konsiderohet si relevante për prodhimin/diseminimin e të dhënave nga Institutet Statistike Kombëtare.

Direktiva “Cookie”

¹ <http://ec.europa.eu/digital-agenda/en/european-legislation-reuse-public-sector-information>

Direktiva 2002/58/EC (Direktiva mbi komunikimet private dhe elektronike, e njohur si direktiva cookie) – kërkon që të gjitha webfaqet brenda BE-së të këshillojnë qartë përdoruesit e tyre rreth përdorimit të ‘cookies’ dhe politikave për trajtimin e informatave personale, që rrjedhin ose merren nga webfaqja dhe vizitorët e saj. Prandaj, zbatimi i direktivës ‘cookie’ i rekomandohet edhe ASK-së, në mënyrë që të jetë në përputhje me kërkesat Evropiane.

2.3 Strategjitë, Politikat dhe procedurat


Gjatë aktivitetit kemi prezantuar se si i kuptojmë ne strategjitë, politikat dhe procedurat e shkruara (që po ashtu mund të shihen si politika të brendshme)

Strategjia

Strategjia duhet t’u tregojë përdoruesve tonë dhe organizatës/stafit tonë, se çfarë iniciativash duhet të ndërmerren për të arritur qëllimet. Pra, iniciativat, që na ndihmojnë të arrijmë aty ku synojmë të arrijmë. Ku duhet të jemi në një të ardhme jo shumë të largët.

Strategy and policy #1

- Strategy. Where we are heading for the coming years:
 - Sets up goals and initiatives for the strategy periode based on the overall goals of the institution



Politika

Si Institut Statistikor Kombëtar, na duhet një politikë e qartë dhe publike mbi diseminimin. Politika duhet të shkruhet për përdoruesit tanë dhe jo për përdorim të brendshëm. Duhet të shpjegojë qartë se çfarë bëjmë ne, çfarë nuk bëjmë dhe çfare duhet të presin përdoruesit nga ne. Pasi bëhet fjalë për politikë, NUK duhet të thotë asgjë për atë që duam të bëjmë. Çka do të bëjmë në të ardhmen sa i përket strategjisë, qoftë në strategjinë e përgjithshme afatgjate të ASK-së, qoftë në strategjinë që i dedikohet diseminimit.

Strategy and policy #2

- Policy. What we are doing now.
 - Principles and rules for the daily production/ dissemination.

Examples:

Data are released every weekday at 11 AM

Errors are corrected and announced on the web site

Documentation is provided to all statistics

Procedurat - udhëzuesit

Politika thekson për përdoruesit procedurat, që përshkruajnë në detaje se çfarë bëjmë ne, si e bëjmë, kush është përgjegjës të marrë veprime dhe kur ndërmerren veprimet e nevojshme për të realizuar atë që ju kemi premtuar përdoruesve në politikën tonë.

2.4 “Kalimi” nëpër Kodin e Praktikës

Siç ceket në raport, kemi diskutuar me përfaqësuesit e ASK-së secilin indikator në Kodin e Praktikës, relevant për diseminimin. Aneksi 3, i bashkëngjitur këtij raporti, paraqet parimet dhe indikatorët relevantë. Sipas mendimin tone, ASK nuk është në një linjë me pritshmëritë e BE-së së paku në dy fusha shumë të rëndësishme. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i disa prej çështjeve të rëndësishme, që janë diskutuar.

Gabimi – Trajtimi

Indikatori 6.3: Deklaron: *gabimet e zbuluara në statistikat e publikuara korrigjohen sa më shpejt që është e mundur dhe bëhen publike.* Dokumentet në pdf zëvendësohen/korrigjohen në webfaqe kur identifikohen gabime. Por, lista e gabimeve të publikimeve të printuara nuk është në dispozicion në webfaqe dhe dokumentet në pdf zëvendësohen pa ndonjë indikacion që ato janë korrigjuar. Prandaj, është e nevojshme që ASK të shkruajë dhe adaptojë procedurat e trajtimit të gabimeve. Së paku, dokumentet në pdf duhet të shënjohen qartë kur ato ndërrohen. Tabelat tek *së shpejti do të publikohen* në databazën *ask.data* duhet të shënjohen me fusnota nëse/kur të dhënat korrigjohen për shkak të gabimeve.

Afati kohor

Indikatori 13.1: *Afati kohor është në përputhje me kërkesat Evropiane dhe standardet e tjera ndërkombëtare të publikimit.* Dokumenti aktual i vitit 2013 nuk adreson afatin kohor në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ne mendojmë që strategjia dhe politika e diseminimit të secilit Institut Statistikor Kombëtar duhet të përfshijë përkushtimin strategjik ndaj afatit kohor. Çështjet kyçe, që lidhen me afatin kohor, mund të adresohen vetëm nga fushat përkatëse/divizionet që prodhojnë statistika, dhe duke siguruar që këto kanë stafin dhe resurset e nevojshme për të prodhuar statistikat sipas afatit kohor të përcaktuar në legjislacionin për ato statistika.

Afati fiks i publikimit

Indikatori 13.2: *Duhet të bëhet publike një orë standarde gjatë ditës për publikimin e Statistikave Evropiane.*

Kalendari i publikimit është në dispozicion në webfaqe – por nuk ka një kohë/orë standarde e publikimit nga ana e ASK-së. Ne e konsiderojmë këtë si një çështje madhore – por që mund të

zgjidhet përmes vendimit të menaxhmentit dhe procedurave të shkruara për procesin e prodhimit / diseminimit.

Njoftimi i vonesave

Indikatori 13.4: *Devijimi nga orari i përcaktuar i diseminimit bëhet publik paraprakisht, duke paraqitur edhe datën e re të publikimit.* Me sa kemi kuptuar, kjo bëhet, por vetëm në versionin e gjuhës shqipe në webfaqe. Duke pasë parasysh prezencën e madhe të ndërkombëtarëve në Kosovë, është e nevojshme të bëhen këto njoftime për vonesat edhe në Gjuhën Angleze. Me sa kemi kuptuar të dhënat mbi përpikërinë janë në dispozicion (13.4.4 *Një procedurë për të kalkuluar, monitoruar dhe diseminuar indikatorët e cilësisë mbi përpikërinë*) dhe të njëjtat kalkulohej dhe i raportohen menaxhmentit sipas nevojës. Besueshmëria e Insitutit Kombëtar të Statistikave do të rritet nëse / kur këto të dhëna bëhen publike.

Të dhënat mikro

Indikatori 15.4: *Qasja në të dhënat mikro është e lejuar për qëllime hulumtimi përmes ndjekjes së rregullave ose protokoleve specifike.* Ligji mbi statistikën në Kosovë rregullon qasjen në të dhënat mikro. Ligji po ashtu është në dispozicion në webfaqe të ASK-së – ne besojmë që politika e diseminimit duhet të përmbajë informata lidhur me qasjen në të dhënat mikro.

Metadat

Indikatori 15.5: *Metadat dokumentohen sipas sistemeve të standardizuara për metadata.* Dokumenti i vitit 2003 ofron pak ose asnjë informatë për metadat. ASK aktualisht është duke punuar në dokumentimin e produkteve të veta statistikore, duke përdorur standardin ESMS². Ky aktivitet është mbështetur kryesisht nga projekti SIDA në ASK. Me përfundimin e tij, ASK do të përmbushë edhe këtë kërkesë pasi metadata është zakonisht një domosdoshmëri që përdoruesit tanë ti përdorin dhe kuptojnë në tërësi statistikën tona, dhe kjo duhet të ceket qartë në politikën e diseminimit.

Dialogu me përdoruesit

Indikatori 11.1: *Janë vendosur proceset për konsultimin e përdoruesve, monitorimin e relevancës dhe shfrytëzimin e statistikave ekzistuese për të përmbushur nevojat e tyre dhe për të marrë në konsideratë nevojat dhe prioritetet e reja të tyre.* Përdorimi i webfaqes monitorohet duke përdorur Google Analytics dhe disa aspekteve të CMS³ aktuale. *Programi i Statistikave Zyrtare 2013-2017* thekson nevojën për t'u konsultuar me përdoruesit për produktet statistikore aktuale dhe të ardhshme. As Programi Zyrtar i Statistikave dhe as Politika e Diseminimit e vitit 2003 nuk e obligon ASK-në për një dialog sistematik me përdoruesit. Ne besojmë fuqishëm që ASK duhet të implementojë një dialog të hapur dhe sistematik me përdoruesit kryesorë.

2.5 Drafti i parë i Politikës së Diseminimit

Bazuar në diskutimet me stafin e ASK-së, që është përgjegjës për diseminimin, ne kemi përgatitur një dokument, që përmban çështjet më të rëndësishme, që duhet të adresohen në

² SDMX Metadata Structure (ESMS) Euro-SDMX Metadata Structure – see <http://ec.europa.eu/eurostat/data/metadata/metadata-structure>

³³ The present CMS (Content Management Systems) will be replaced in the coming years by support from the SIDA project. The ask.data system based on PX-Web (implemented by the Twinning Project) also provides data on the extraction / downloads of data tables.

politikën e diseminimit. Nëse dhe atëherë kur këto çështje adresohen, ASK do të arrijë të një politikë diseminimi e shkurtër dhe e saktë, që është në përputhje me pritshmëritë që rrjedhin nga Kodi i Praktikës dhe Korniza e Sigurimit të Cilësisë. Një draft mjaft i gjerë paraqitet në në Ankesin 4.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Bazuar në diskutimet tona, mund të paraqesim disa rekomandime të përgjithshme fillestare. Do të ketë së paku edhe një aktivitet shtesë pas 4.9.1. Raporti mbi këtë aktivitet do të përmbajë rekomandimet kryesore. Në aktivitetin e radhës po ashtu do të diskutohen iniciativat strategjike relevante, që të adresohen brenda periudhës aktuale të planifikuar nga ASK.

- ASK duhet të përpilojë draftin e politikës së diseminimit bazuar në pritshmëritë e Kodit të Praktikës.
- ASK duhet të harmonizojë politikën me legjislacionin relevant në Kosovë,
- Drafti i politikës duhet të jetë i gatshëm sa më shpejt që është e mundur – e preferueshme në Qershor / Korrik
- Drafti duhet të diskutohet dhe të plotësohet nga menaxhmenti i lartë
- Drafti i politikës duhet të finalizohet me ne më së voni deri në fund të Gushtit/fillim të Shtatorit
- Zhvillimi i politikës së brendshme / procedurës për trajtimin e gabimeve
- Zhvillimi i politikaës së brendshme / procedurës të gjithë hapat e procesit të publikimit
- Vendimi mbi kohën fikse dhe të saktë të ditës, kur do publikohen të gjitha statistikat
- Afatet kohore dhe saktësia e të dhënave duhet të prezantohen sistematikisht, të raportohen te menaxhmenti i lartë dhe të publikohen

Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së
KS12 IB ST 01
Përkrahje për Statistikat

Termat e Referencës:

Komponenti 4: Sistemi i Teknologjisë Informative dhe Diseminimi
Aktiviteti 4.9.1: Përmirësimi i Diseminimit – Zhvillimi i Strategjisë së Diseminimit

Afatet:

TeR –data e finalizimit: 20 Prill 2015
Fillimi / fundi i aktivitetit: 4-7 Maj 2015
Koha e raportimit: 15 Maj 2015

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
-----------------------	--------------------	------------	-------------------------	-----------

<p>Aktiviteti 4.2</p>	<p>Zhvillimi i sistemeve të TI diseminimit permes web-it</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Web faqja e ASK dhe përmirësimi i përdorimit të saj nga tremujori i 8-të i projektit • Diseminimi i databazës i instaluar dhe në dispozicion për publikun nga tremujori i 7 i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> • Raportet Tremujore të Binjakëzimit • Raportet e Misionit 	<ul style="list-style-type: none"> • Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit • Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim • Staf i punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve • Termat e Referencës të detajuara janë zhvilluar në kohën e duhur, duke detajuar detyrat (inputin), outputin e pritur, pjesëmarrësit e aktivitetit dhe agjendës
----------------------------------	---	--	---	---

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 4.9.1

Zhvillimi i strategjisë së diseminimit për ASK

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 4.9.1

- Vlerësimi i diseminimit aktual në ASK
- Harta rrugore për zhvillimin e strategjisë së diseminimit

Programi i statistikave zyrtare 2013-2017 i ASK-së deklaron që duhet të zhvillohet procedura e diseminimit, përfshirë udhëzuesit për dizajnin e tabelave, grafikëve dhe për përmirësimin e webfaqes. Më tutje kjo është diskutuar në takimin e komitetit drejtues të Binjakëzimit. Kërkesa është parashtruar nga kryeshefi ekzekutiv dhe ky aktivitet është aprovuar dhe përfshirë në programin e Binjakëzimit.

Gjatë misionit të parë ASK do t'i shpjegojë ekspertëve të vendeve anetare në lidhje me të gjitha aktivitetet e diseminimit dhe si menaxhoen ato në këtë fazë.

Ekspertët e VA do t'i shpjegojnë stafit të ASK-së në lidhje me politikat e diseminimit të Statistikave të Danimarkës dhe strategjinë e diseminimit. ASK dhe përfaqësuesit e VA do të krijojnë një matricë të aktiviteteve aktuale të ASK-së dhe aktiviteteve të Statistikave të Danimarkës në fushën e diseminimit. Matrica do të përdoret si mjet për të zhvilluar strategjinë e diseminimit. Më tutje, ekspertët e VA do të diskutojnë me stafin e ASK-së në lidhje me kërkesat relevante të BE-së për diseminimin e statistikave.

Do të zhvillohet një hartë rrugore për zhvillimin e strategjisë së diseminimit. Përfshirë përshkrimin e aktiviteteve të reja në kuadër të ASK-së dhe po ashtu misioneve të reja që nevojiten. Harta rrugore duhet ta marrë parasysh burimet e kufizuara në ASK.

Stafi i ASK-së:

1. Znj. Hazbije Qeriqi, Zyrtare për Komunikim, ASK, hazbije.qeriqi@rks-gov.net
2. Znj. Drita Sylejmani, Zyrtare e Diseminimit, Drita.sylejmani@rks-gov.net,
3. Znj. Shqipe Gashi, Zyrtare e Diseminimit, ASK shqipe.gashi@rks-gov.net
4. Z. Burim Limolli, Shef i TI-së - Divizioni, burim.limolli@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net
Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Ms Annegrete Ëulff, Shef i Divizionit, Statistikat e Danimarkës, awu@dst.dk
Mr Jesper Ellemose Jensen, Këshilltari Kryesor, Statistikat e Danimarkës, jej@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk
Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Historiku

Në përgjithësi aktivitetet në komponentin 4 do të adresojnë këto çështje:

- Përmirësimi i diseminimit përmes web faqes i statistikave të caktuara, duke përfshirë përmirësimin e webfaqes së ASK-së dhe duke e bërë atë më të lehtë për ta përdorur dhe mjet më fleksibil të diseminimit ;
- Zhvillimi i udhëzuesve për dizajnimin e tabelave dhe grafikëve, që po ashtu të përdoren për diseminim përmes webfaqes;
- Zhvillimi i databazës së diseminimit, përfshirë metadata më të kompletuara që mbulojnë aspekte të ndryshme, që lidhen me cilësinë e të dhënave;
- Përmirësimi i komunikimit të drejtpërdrejtë me përdoruesit
- Prezantimi i Kodit të Praktikës, aspekti i diseminimit
- Zhvillimi i strategjisë së diseminimit

Aktivitetet që duhet të ndërmerren si parapërgatitje për misionin:

Lista e dokumentave të bashkangjitura

- Programi i statistikave zyrtare 2013 -2017
- Raportet mbi misionet në Projektin e Binjakëzimit, Komponenti 4 (të gjitha në dispozicion në dst.dk/Kosovo)

Programi, - Maj 2015

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	10:00	Hyrje në këtë pjesë të komponentit 4
		10:15	ASK paraqet gjendjen aktuale në fushën e diseminimit
		11:00	Pushim për kafe
		11:15	Ekspertët paraqesin strategjinë e diseminimit të Statistikave të Danimarkës dhe aktivitetet e diseminimit. Çka është Strategjia? Dhe çka është Politika?
		12:00	Dreka
		13:30	Kërkesat e BE-së: Kërkesat Evropiane / Eurostat-it për Diseminim bazuar në Kodin e Praktikës dhe Kornizën e Sigurimit të Cilësisë
		14:30	Pushim për kafe
		15:00 – 16:00	Përgatitja e matricës/dokumenti që paraqet përputhjen e ASK-së me pritshmëritë e BE-së në fushën e diseminimit
2	KAS	09:00- 16:00	PËRDORUESIT: Çfarë njohurish ka ASK në lidhje me përdoruesit e tyre, aktual dhe të ardhshëm? Definimi dhe të kuptuarit e nevojave të përdoruesve? Matrica e përdoruesve, nevojat e përdoruesve dhe produktet në dispozicion? Caktimi i prioriteteve në mesin e përdoruesve/grupeve të përdoruesve
3	KAS	09:00- 16:00	Konkluzionet dhe rekomandimet: Diskutimet se si të zhvillohet strategjia e diseminimit për ASK– mënyra më e mirë përpara Dakordimi i titujve për Strategjinë Autorët Procedurat për Strategjinë - aprovimi Planifikim i misionit të radhës Shkrimi i Raportit Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

Aneksi 2. Personat e takuar

Stafi i ASK-së:

- Z.Burim Limolli, Shef i TI-së - Divizioni, burim.limolli@rks-gov.net ASK
1. Z.Idriz Shala, Ekspert i GIS, idriz.shala@rks-gov.net, ASK
 1. Znj.Drita Sylejmani, Zyrtare e Diseminimit, Drita.sylejmani@rks-gov.net, ASK
 2. Znj.. Shqipe Gashi, Zyrtare e Diseminimit, Shqipe.gashi@rks-gov.net, ASK
 3. Znj.. Kumrije Beqiri, Zyrtare e Diseminimit, kumrije.beqiri@rks-gov.net, ASK
 4. Z. Bekim Canolli, Shef i Metodologjisë, Bekim.canolli@rks-gov.net
 5. Z.. Haki Kurti, Shef i Ambientit , haki.kurti@rks-gov.net
 6. Z. Hydai Morina,Zyrtare për SILC, hyday.morina@rks-gov.net
 7. Znj. Bedrije Demaj, Zyrtare për LFS, Bedrije.demaj@rks-gov.net
 8. Znj. Flutura Shosholli, Zyrtar për statistikat e ambientit. Flutura.shosholli@rks-gov.net
 9. Znj. Hazbije Qeriqi, Zyrtare për Komunikim dhe Informim, hazbije.qeriqi@rks-gov.net

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Agim Aliu, Përkthyes

Aneksi 3 – Matrica e pritshmërive nga Kodi i Praktikës

Parimi:	Pse jemi në përputhje?	Pse nuk jemi në përputhje?	Hapat që rrisin përputhmërinë
Parimi 6: Paanshmëria dhe objektiviteti			
Autoritetet statistikore zhvillojnë, prodhojnë dhe diseminojnë Statistikat Evropiane duke respektuar pavarësinë shkencore dhe në mënyrë objektive, profesionale dhe transparente, ku të gjithë përdoruesit trajtohen njësoj			
Indikatori 6.1: Statistikat përpilohen në mënyrë objektive duke pasur për bazë faktet statistikore.			
Indikatori 6.2: Përzgjedhja e burimeve, metodave statistikore dhe vendimeve për diseminimin e statistikave bazohen në faktet statistikore.			
Indikatori 6.3: Gabimet e zbuluara në statistikat e publikuara korrigojnë sa më herët që është e mundur dhe bëhen publike.			
Indikatori 6.4: Informacionet mbi metodat dhe procedurat e përdorura bëhen publike			
Indikatori 6.5: Datat dhe koha e publikimeve statistikore paralajmërohen.			
Indikatori 6.6: Paralajmërohet për ndonjë rishikim ose ndryshim të madh të metodologjisë			

Indikatori 6.7: Të gjithë përdoruesit kanë qasje të barabartë në publikimet statistikore në të njëjtën kohë. Qasjet e privileguara, të parakohshme për ndonjë përdorues të jashtëm, janë të kufizuara, të kontrolluara dhe publike. Në rast se ndodh qasja e parakohshme e paplanifikuar, duhet të rishikohet koha e publikimit dhe të bëhet për të gjithë njësoj.

--	--	--	--

Indikatori 6.8: Publikimet dhe deklaratat statistikore të bëra në konferencat për shtyp duhet të jenë objektive dhe të paanshme.

--	--	--	--

Parimi 11: Relevanca

Statistikat Evropiane plotësojnë nevojat e përdoruesve.

Indikatori 11.1:

Ekzistojnë procese për konsultimin me përdoruesit, monitorimin e relevancës dhe shfrytëzueshmërisë së statistikave ekzistuese në plotësimin e nevojave të tyre, si dhe marrjen në konsideratë të nevojave dhe prioritetëve të reja të tyre.

1. Legjislacioni mbi konsultimet me përdoruesit			
2. Aktivitetet e konsultimit me përdoruesit			
3. Analizimi i të dhënave mbi përdorimin e statistikave			
4. Klasifikimi i përdoruesve			
5. Lista e përdoruesve kyç dhe të dhënat që ata përdorin			
6. Procedurat e konsultimit me përdoruesit			
7. Matja dhe vlerësimet e relevancës			

Indikatori 11.2:

Nevojat prioritare plotësohen dhe kjo reflektohet në programin e punës.

1. Prioritetet e programit të punës			
2. Qëllimet strategjike dhe planet e programit			
3. Marrëveshjet me përdoruesit më të rëndësishëm			
4. Vlerësimi i programit të punës			

Indikatori 11.3: Kënaqshmëria e përdoruesve monitorohet rregullisht dhe përcillet sistematikisht.			
1. Anketat mbi kënaqshmërinë e përdoruesve			
2. Veprimet me qëllim përmirësim, pas anketës së kënaqshmërisë së përdoruesve			
3. Vlerësimi i nivelit të kënaqshmërisë të përdoruesve kryesorë			

Parimi 12: Saktësia dhe Besueshmëria			
Indikatori 12.1: Të dhënat burimore, rezultatet preliminare dhe produktet statistikore vlerësohen dhe validohen rregullisht.			
1. Sistemet për vlerësimin dhe validimin e të dhënave			
2. Procedurat dhe udhëzuesit për vlerësimin e cilësisë së të dhënave			
3. Krahasimi i rezultateve me burime të tjera			
Indikatori 12.2: Gabimet e mostrimit dhe ato, që nuk lidhen me mostrën, maten dhe dokumentohen sistematikisht sipas standardeve Evropiane.			
1. Procedurat dhe udhëzuesit për matjen dhe reduktimin e gabimeve.			
2. Raportimi cilësor mbi saktësinë.			
3. Rekomandimet e Sistemit Statistikor Evropian mbi raportimin e cilësisë.			
4. Metodot dhe mjetet për parandalimin dhe reduktimin e gabimeve.			
Indikatori 12.3: Rishikimet analizohen rregullisht me qëllim të përmirësimit të proceseve statistikore.			
1. Politika e rishikimit.			
2. Shpjegimet mbi rishikimet.			

3. Përputhshmëria e Politikës së Rishikimit me procedurat standarde.			
4. Informacionet mbi shkallën dhe drejtimin e rishikimeve për indikatorët kyç.			
5. Përdorimi i analizave të rishikimeve.			

Parimi 13: Afatet kohore dhe përpikëria			
Indikatori 13.1: Afatet kohore janë në përputhje me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare për publikimet.			
1. Përputhshmëria me standardet evropiane mbi afatet kohore			
2. Publikimi i kalendarit të publikimeve.			
3. Procedura për monitorimin dhe trjtimin e devijimeve nga afatet kohore.			
4. Indikatori(ët) e cilësisë mbi afatet kohore.			
5. Analizimi dhe vlerësimi i indikatorit(ët) të cilësisë mbi afatet kohore			
Indikatori 13.2: Ekziston një kohë/orë standarde brenda ditës kur bëhet publikimi i statistikave dhe kjo bëhet publike.			
1. Politika e publikimit.			
2. Publikimi në një kohë standarde/të njëjtë të ditës			
Indikatori 13.3: Periodiciteti i statistikave merr parasysh kërkesat e përdoruesve, sa më shumë që është e mundur.			
1. Konsultimet me përdoruesit në lidhje me periodicitetin e statistikave.			
Indikatori 13.4: Devijimi nga afati i diseminimit publikohet paraprakisht, shpjegohet dhe caktohet një date e re e publikimit.			

1. Publikimi i kalendarit të publikimeve.			
2. Procedura për monitorimin dhe vlerësimin e përpikërisë			
3. Publikimi i devijimit nga koha e paralajmëruar e publikimit, arsyet e mos publikimit me kohë dhe koha e re e publikimit.			
4. Procedura për kalkulimin, monitorimin dhe diseminimin e indikatorëve të cilësisë mbi përpikërinë.			
Indikatori 13.5: Rezultatet preliminare me saktësi të pranueshme mund të publikohen, kur konsiderohet e dobishme.			
1. Rishikimi i mundësisë të diseminimit të rezultateve preliminare.			
2. Raportimi i cilësisë së rezultateve preliminare			
3. Politika për orarin e rishikimeve			
Parimi 14: Koherenca dhe Krahasueshmëria			
Indikatori 14.1: Statistikat kanë koherencë dhe konsistencë të brendshme (p.sh. identitetet aritmetike dhe kontabël).			
1. Procedurat dhe udhëzuesit për monitorimin koherencës së brendshme.			

2. Procedurat dhe udhëzuesit për sigurimin e kombinimit të rezultateve nga burime plotësuese.			
Indikatori 14.2: Statistikat janë të krahasueshme përgjatë një periudhe të arsyeshme kohore.			
1. Ndryshimet në koncepte.			
2. Identifikimi dhe matja e ndryshimeve në metodat.			
3. Publikimi dhe shpjegimi i ndërprerjeve në seritë kohore.			
Indikatori 14.3: Statistikat përpilohen mbi bazën e standardeve të përbashkëta në lidhje me fushë-shtrirjen, definicionet, njësitë dhe klasifikimet në anketa dhe burime të ndryshme.			
1. Mekanizmi për promovimin e koherencës dhe konsistencës			
2. Vlerësimi i përputhshmërisë me standardet.			
3. Shpjegimi i devijimeve nga standardet			
Indikatori 14.4: Statistikat nga burime të ndryshme dhe me periodicitet të ndryshëm krahasohen dhe përputhen.			
1. Krahasimi i produkteve statistikore me të dhënat përkatëse			
2. Identifikimi dhe shpjegimi i devijimeve			
3. Përputhshmëria e produkteve statistikore			

Indikatori 14.5: Krahasimi i të dhënave brenda vendit sigurohet në kuadër të Sistemit Statistikor Evropian përmes shkëmbimeve periodike midis SSE dhe sistemeve të tjera statistikore. Bëhen analiza të metodologjisë në bashkëpunim të ngushtë midis vendeve anëtare dhe Eurostatit.			
1. Institucionalizimi i vlerësimit të krahasueshmërisë			
2. Bashkëpunimi në studime rreth metodologjisë			
3. Vlerësimi i krahasueshmërisë së të dhënave nga Eurostatit.			
4. Analizimi i asimetrive			
5. Identifikimi i korigjimeve dhe diskrepancës në pasqyrat statistikore.			

Parimi 15: Qasja dhe Qartësia.**Indikatori 15.1:**

Statistikat Evropiane dhe metadatat shoqëruese paraqiten dhe arkivohen në një formë të tillë, që mundëson interpretimin e saktë dhe krahasimet e nevojshme.

1. Politika e Diseminimit			
2. Konsultimet me përdoruesit në lidhje me diseminimin			
3. Trajnimet për shkrimin e interpretimeve dhe komunikatave për shtyp			
4. Politika për arkivimin e statistikave dhe metadatave			
5. Krahasimet e përfshira në publikime			

Indikatori 15.2:

Shërbimi i diseminimit përdor teknologjinë informative dhe të komunikimit dhe, nëse e nevojshme, kopjet e shtypura në letër.

1. Webfaqja dhe databaza statistikore në pajtim me udhëzuesit univerzal.			
2. Webfaqja, databazat statistikore dhe vet-krijimi i tabelave			
3. Shërbimi i qendrës së thirrjeve			
4. Katalogu i publikimeve.			
5. Lehtësimi i ri-diseminimit.			

6. Marrja në konsideratë e formave të ndyshme të diseminimit.			
Indikatori 15.3: Analiza specifike sipas kërkesës ofrohen kur është e mundur dhe për këtë informohet publiku.			
1. Komunikimi në lidhje me analizat specifike në bazë të një kërkesë.			
2. Ofrimi i rezultateve të veçanta/sipas kërkesës .			
3. Publikimi i analizës sipas kërkesës			
4. Shërbimi përgjegjës për kërkesat për analiza specifike			
Indikatori 15.4: Qasja në të dhënat mikro lejohet për qëllime hulumtimi, në bazë të rregullave ose protokoleve specifike.			
1. Konsultimet me hulumtuesit			
2. Publikimi i rregullave ose protokoleve për qasjen në të dhënat mikro.			
3. Ambientet e sigurta për qasjen në të dhënat mikro.			
4. Qasja nga larg.			
Indikatori 15.5: Metadatat dokumentohen sipas sistemeve të standardizuara për metadatat.			
1. Diseminimi i rezultateve statistikore dhe metadatave			
2. Metadatat që lidhen me produktin statistikor.			

3. Përputhshmëria e metadatave me Standardet Evropiane			
4. Metadatat e pavarura nga formati i publikimit			
5. Procedurat për përditësimin dhe publikimin e metadatave			
6. Sqarimi i çështjeve, që lidhen me metadatat			
7. Trajnimi i stafit mbi metadatat			
Indikatori 15.6: Përdoruesit informohen lidhur me metodologjinë e proceseve statistikore, përfshirë përdorimin e të dhënave administrative.			
1. Planifikimi i prodhimit të raporteve të cilësisë			
2. Publikimi i raportit të cilësisë dhe dokumenteve mbi metodologjinë			
Indikatori 15.7: Përdoruesit informohen lidhur me cilësinë e produkteve statistikore sipas kritereve të cilësisë për Statistikat Evropiane.			
1. Publikimi i raporteve të cilësisë			
2. Përputhshmëria e raporteve me standardet dhe udhëzuesit e Sistemit Statistikor Evropian.			

Aneksi 4 – Titujt për politikën e diseminimit

Titujt / pikët në vijim i janë prezantuar ASK-së, si minimum që do të duhej të përfshihej në politikën e diseminimit. Nuk janë përfundimtare dhe duhet të radhiten dhe titullohen në atë mënyrë që përshtaten me mënyrën e të menduarit të ASK-së.

Diseminimi

Diseminimi në ASK është dizajnuar për të implementuar vizionin e përgjithshëm të ASK-së.

Vizioni i ASK-së

Misioni është të plotësohen nevojat e përdoruesve për statistika cilësore, të besueshme dhe objektive. Të dhënat do të jenë në disipozicion në afatet kohore dhe do të paraqiten në atë mënyrë që të ndihmojnë planifikimin dhe zhvillimin në nivel vendi, komune dhe vendbanimi. Sistemi i statistikave duhet t'i furnizojë me informata statistikore cilësore në baza të rregullta institucionet qeveritare, komunitetet hulumtuese dhe institucionet akademike, komunitetet ndërkombëtare, komunitetin e biznesit, shoqërinë civile dhe publikun e përgjithshëm. Sistemi duhet të përputhet me Ligjin mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe të praktikatat e menaxhmentit modern në vijë me standardet ndërkombëtare.

Korniza ligjore

ASK është përgjegjëse për grumbullimin, prodhimin dhe diseminimin e të dhënave statistikore sipas ligjit mbi Statistika (referenca?). Të gjitha aktivitetet e ASK realizohen sipas udhëzuesve ndërkombëtarë relevantë, siç janë Kodi i Praktikës të Eurostat-it dhe Parimet Fundamentale të Statistikave të Kombeve të Bashkuara.

Pavarësia

Çfarë të thuhet këtu?

Platformat

Webfaqja e ASK-së dhe databaza ask.data janë platforma kryesore për diseminimin e të dhënave. Informatat në webfaqe ofrohen pa pagesë. Printimi përdoret kur është e nevojshme (vjetari statistikor). ASK komunikon me përdoruesit në rrjetet sociale siç janë Facebook dhe Twitter. Duhet të zhvillohen udhëzuesit e brendshëm për media sociale.

Përdoruesit

Diseminimi që realizon ASK-ja është dizajnuar të reflektojë nevojat e të gjithë përdoruesve. ASK punon me grupet e përdoruesve si në vijim:

Me ministritë, institucionet tjera vendore zyrtare, hulumtuesit, mediat dhe publikun e gjerë, si dhe me organizatat ndërkombëtare siç janë, BE, KB, FMN, Bankën Botërore, BERZH

Për çfarë kemi rënë dakord? Çfarë dëshironi të ketë prioritet?

Dialogu me përdoruesit? – Takimet me përdoruesit.

Gjuha

ASK përpiqet të publikojë të gjitha informatat në 3 gjuhë, Gjuhën Shqipe, Serbe dhe në Gjuhën Angleze. Të gjitha tabelat në ask.kas dhe të gjitha metadatat sipas standardeve Evropiane, ESMS, janë në dispozicion në tri gjuhët. Është kërkesë ligjore në Kosovë. Nëse

nuk mund të bëni gjithçka në tri gjuhët – atëherë së paku duhet ta keni si qëllim të cekur në Strategji dhe/ose të theksoni qartë çfarë nuk keni në të tri gjuhët.

Publikimet

Të gjitha publikimet statistikore (theksoni saktë çfarë keni në kalendar) janë të parajlmëruara në webfaqen e ASK-së/kalendari i publikimit. Të gjitha publikimet bëhen në ora x.z (menaxhmenti duhet të vendosë një kohë fikse të publikimit) Afatet kohore dhe përpikëria e të gjitha statistikave të prodhuara në ASK monitorohen sistematikisht dhe krahasohen me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Të dhënat mbi afatet kohore dhe përpikërinë publikohen në baza vjetore/ tremujore – së paku ne rekomandojmë që ta realizoni këtë – nëse jo tani, së paku të jetë një nga qëllimet strategjike dhe duhet të ketë procedura të brendshme/dokumentimi për këtë.

Të gjithë përdoruesit trajtohen barabartë. Nuk ekziston asnjë marrëveshje speciale për shpërndarjen e të dhënave me ndonjë grup të caktuar të përdoruesve. Nëse keni marrëveshje speciale – këto duhet të përshkruhen.

E drejta e autorit

Të gjitha të dhënat në webfaqen tonë dhe në ask.data mund të përdoren pa pagesë, nëse ASK citohet si burim.

Besueshmëria/ Transparenca / Gabimet

ASK bën përpjekje maksimale për të shmangur gabimet në materialet e publikuara. Kur gjendet ndonjë gabim, gabimi korrigjohet sa më shpejt që është e mundur. Nëse gabimet gjenden në dokumentet pdf, atëherë shtohet një dokument i ri – ndryshimet në këtë dokument shënjohen qartë. Nëse gabimet gjenden në tabelat në databazën ask.data, atëherë i shtohet një shpjegim shtesë tabelës. ASK bën dallimin midis gabimeve të mëdha, që ndikojnë në të kuptuarit/ interpretimin e statistikave, dhe gabimeve jo të rëndësishme. Gabimet jo të rëndësishme mund të korrigjohen pa lajmërim. [Shih fx\(<http://www.ssb.no/en/omssb/styringsdokumenter/formidlingspolitikk>\) si shembull.](http://www.ssb.no/en/omssb/styringsdokumenter/formidlingspolitikk) Trajtimi i gabimeve duhet të përshkruhet në një procedurë të brendshme/udhëzues/politikë, ku shpjegohen qartë përgjegjësitë e secilit, si dhe kur – Të jenë të shkruara.

Keqkuptimet

ASK reagon ndaj keqkuptimeve dhe keqpërdorimit të të dhënave tona. Diskutoni se çfarë mund të thuhet këtu gjatë aktivitetit për të bashkëpunimin me shtypin.

Qasja

Metadata/Dokumentimi

Metadat (të dhënat për të dhënat) janë të nevojshme për përdoruesit në mënyrë që ata t'i kuptojnë dhe prdorin plotësisht statistikën e përgatitura nga ASK. Metadatat përpilohen dhe diseminojnë sipas standardit ESMS të Eurostat-it. Të gjitha publikimet/tabelat në ask.data janë të lidhura me metadatat përkatëse. **NËSE JO TANI, ky duhet të jetë një qëllim strategjik i ASK-së.**

Klasifikimet

Sipas klasifikimeve ndërkombëtare.

Konfidencialiteti

Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga ASK-ja trajtohen me maturi maksimale dhe konfidencialitet. Diseminimi bëhet në nivel të agreguar, kështu që asnjë informatë sa i përket personave fizikë apo kompanive, nuk mund të identifikohet. Duhet të zhvillohen procedura të brendshme me shkrim për konfidencialitetin – një përshkrim i përgjithshëm i konfidencialitetit duhet të jetë në dispozicion në webfaqe. Duke iu referuar ligjit mbi ASK.

Qasja në të dhënat mikro

Nën kushte të caktuara, është e mundur qasja në të dhënat mikro, anonime, për qëllime hulumtimi. Edhe një përshkrim i kësaj duhet të jetë në dispozicion në webfaqe. Duhet të zhvillohen procedura të brendshme të shkruara për këtë qëllim, nëse aktualisht nuk ekzistojnë.